



PREFEKTURA SHKODËR

Nr. 432/ Prot.
Shkodër, më 29/06/2023



"ILLYRIAN GUARD" SHA

Nr. 1166 Prot.
Tiranë, më 29/06/23

KONTRATË SHËRBIMI

Titulli i kontratës: Shërbim Sigurie për ruajtjen fizike të ndërtesave, aseteve dhe njerëzve të Prefektura Shkodër me punonjës shërbimi dhe sistem vëzhgimi dhe sinjalizimi.

E lidhur më datë ____/____/____ ndërmjet palëve:

Prefektura Shkodër, me NIPT K56705030C, me adresë: Rruga "28 Nëntori", Shkodër, përfaqësuar nga **Znj. Majlinda Angoni**, në cilësinë e Prefekti Qarku Shkoder, tani e tutje të referuar si "**Subjekti Përfitues i Shërbimit**"

Dhe

Shoqëria "Illyrian Guard" SHA, me adresë: Rruga Ibrahim Rugova, Ish Garda e Republikës, Tiranë, e cila është e organizuar dhe ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin Shqiptar e Regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit me numër identifikimi NUIS: L91619024U, me numër licence LN-7531-06-2019 për "Sigurimin fizik të objekteve shtetërore e private, të personave, si dhe veprimtarive social-kulturore, sportive, fetare e politike", përfaqësuar nga Administratori **Z. Robert LILI**, tani e tutje të referuar si "**Ofruesi i Shërbimit**".

Referuar dispozitave të Kodit Civil të RSH, bazuar në Ligjin Nr. 75/2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike" i ndryshuar, Ligji Nr.10 296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Udhëzimi Nr.130 datë 05.03.2018 të Ministrit të Brendshëm "Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike", VKM-së Nr. 177, datë 04.04.2019 "Për krijimin e Shoqërisë "Illyrian Guard" ShA, Udhëzimin e Përbashkët të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr. 407/1, datë 14.06.2019 si dhe aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë këtë fushë, bie dakort të realizojë shërbimin ashtu siç është specifikuar në kushtet e përcaktuara në:

- Këtë Formular Kontrate
- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës
- Kushtet e Veçanta të Kontratës
- Formularin e Përgjegjësisë Profesionale
- Rregulloren e Përbashkët të Sigurisë





PREFEKTURA SHKODËR

"ILLYRIAN GUARD" SHA

5. "Subjekti Përfitues i Shërbimit" do të thotë Autoriteti që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen shërbimin. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të përkufizuar në ligj.
6. "Ofrues i Shërbimi" do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.
7. "Shërbime" do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Ofruesi i Shërbimit sipas kontratës.

I. OBJEKTI, VLERA, KOHËZGJATJA E KONTRATËS

Neni 2

OBJEKTI I KONTRATËS

Kjo kontratë ka për objekt: "Shërbim Sigurie për ruajtjen fizike të ndërtesave, aseteve dhe njerëzve të **Prefekturës Shkodër**", me punonjës shërbimi dhe sistem vëzhgimi dhe sinjalizimi **për një periudhë 5 (pesë) mujore**.

Neni 3

ÇMIMI DHE VLERA E KONTRATËS

Vlera e përgjithshme e kontratës që përfshin realizimin e shërbimit është si më poshtë:

Vlera mujore e kontratës me 1.18 punonjës shërbimi dhe 1 sistem elektronik është: 1.18×71.243 (tarifa për roje) = 84,066.74 + 190,206 (tarifa për sistem elektronik) = 274,272.74 (dyqind e shtatëdhjetë e katër mijë e dyqind e shtatëdhjetë e dy pikë shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.

Vlera totale e kontratës për 5 (pesë) muaj është: $274,272.74 \times 5 = 1,371,363.7$ (një milion e treqind e shtatëdhjetë e një mijë e treqind e gjashtëdhjetë e tre pikë shtatë) lekë pa TVSH.

Vlera totale e kësaj do të jetë sipas Aneksit Nr.1, pika 3.

Efektet juridike dhe financiare të kontratës fillojnë më datë **01.07.2023**.

Neni 4

AFATET E PAGESËS

1. Çmimi i kontratës, duke përfshirë çdo pagesë paraprake, duhet të paguhet në kohë siç specifikohet në kontratë, pas firmosjes së Procesverbalit mujor të kryerjes së shërbimit nga të dy palet sipas Aneksit Nr. 5.
2. Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa duhet bërë në monedhë Shqiptare. Kursi i shkëmbimit të monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankës së Shqipërisë në ditën kur është dërguar njoftimi i kontratës për botim.





PREFEKTURA SHKODËR



“ILLYRIAN GUARD” SHA

- Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, kërkesa e ofruesit të shërbimit për pagesë duhet t'i bëhet Përfituesit të Shërbimit me shkrim. Për çdo kërkesë, ofruesi i shërbimit duhet të paraqesë origjinalin dhe kopje së bashku me një listë të sendeve që përshkruan shërbimet e kryera për të cilat duhet paguar.

Neni 5

VONESA NË BËRJEN E PAGESËS

- Në rast të verifikimit të vonesave në kryerjen e pagesave nga ana e përfituesit të Shërbimit megjithëse ofruesi i shërbimit ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij në përputhje me kushtet e kontratës, detyrimet e prapambetura dhe kamat vonesave përkatëse do të kryhen në përputhje me parashikimet e ligjit nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”.

Neni 6

KOHËZGJATJA E KONTRATËS

- Kohëzgjatja e kryerjes së shërbimit objekt i kontratës do të jetë **për një periudhë 5 (pesë) mujore**, nga data **01.07.2023** deri më **30.11.2023**.

II. KUSHTET E KONTRATËS

Kushtet e kontratës, përfshijnë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës (KPK) dhe Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

II.1 KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS

Neni 7

QËLLIMI

- Kushtet e përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen nga palët kontraktore për blerjen e shërbimit objekt kontrate. Disa dispozita të Kodit Civil janë ri shprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- Dispozita të Ligjit “Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike” janë ri shprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike.
- Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike. KPK do të





PREFEKTURA SHKODËR

"ILLYRIAN GUARD" SHA

ofrohet shërbimi sipas Aneksit nr.1, situacionet për shërbimet e kryera në fakt të nënshkuara nga përfaqësuesit e të palëve.

3. Dorëzimi me vonesë i faturës nga ana e Ofruesit të Shërbimit, jashtë afatit të nënshkuar në kontratë, do të shoqërohet me dhënien e masës administrative me gjobë për ditë vonesë, referuar nenit 22 të kësaj kontrate.
4. Monedha e pagesës do të jetë monedha Shqiptare "Lekë". Kjo pagesë do të bëhet në Bankën Intesa San Paolo Bank, Nr.Llogarisë: 29042331101, IBAN: AL33 2081 1008 0000 0290 4233 1101.

Neni 40 GARANCITË

1. Ofruesi i Shërbimit garanton si më poshtë:
 - Kryerjen e shërbimeve me kujdes të arsyeshëm dhe zotësi në zbatim të Ligjit 75/2014, dt. 14.07.2014 i ndryshuar, Udhëzimit nr.130 datë 05.03.2018 të Ministrit të Brendshëm, VKM-së nr. 177, datë 04.04.2019, Udhëzimit të Përbashkët të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 407/1, dt. 14.06.2019.
 - Kryerja e shërbimeve në zbatim të kësaj Kontrate do të pajtohet me termat, kushtet dhe specifikat e përfshira në **Rregulloren Brendshme të Sigurisë së Objektivit** bashkëngjitur kësaj Kontrate.
 - Gjatë kryerjes së Shërbimit, Ofruesi i Shërbimit duhet të veprojë në interesin më të mirë të Përfituesit të Shërbimit, Ai garanton që punonjësit e tij do të karakterizohet nga një sjellje korrekte dhe do të pranojnë dhe zbatojnë kërkesat e legjislacionit shqiptar mbi shëndetin dhe sigurinë në punë.
 - Të gjitha pajisjet e destinuara për kryerjen e shërbimeve duhet të jenë cilësore, në dispozicion dhe të përdoren nga një personel dhe i përgjegjshëm. Ky rregull vlen dhe për pajisje shtesë, të cilat Ofruesi i shërbimit ka për qëllim ti përdorë për përmbushjen e shërbimeve.
 - Përfituesi i Shërbimit duhet të bashkëpunojë me korrektësi me personelin e Ofruesit të shërbimit. Ai duhet të krijojë kushte të përshtatshme për kryerjen e shërbimit nga pala kontraktore.

Neni 41 DISPOZITAT E FUNDIT

1. Kjo Kontratë pranohet me të gjitha kushtet dhe termat e saj. Ajo do të rregullohet, interpretohet dhe zbatohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.





PREFEKTURA SHKODËR



"ILLYRIAN GUARD" SHA

2. Kjo kontratë hartohet në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe, ekzemplarë me përmbajtje të njëjtë, ku 2 (dy) kopje janë për Përfituesin e Shërbimit dhe 2 (dy) kopje për Ofruesin e Shërbimit. Çdo kopje ka të njëjtën përmbajtje dhe të njëjtën vlerë ligjore.
3. Palët pasi e lexojnë, kuptojnë dhe pranojnë përmbajtjen e kontratës, me vullnetin e tyre të lirë e nënshkruajnë atë.

U nënshkrua në Tiranë, sot më datë ____ . ____ . ____

PALËT KONTRAKTORE

PREFEKTURA SHKODËR

ILLYRIAN GUARD ShA

Majlinda ANGONI

Robert LILI

PREFEKT I QARKUT SHKODER

Administrator



Konc.: A. Osmani
Sigloi: E. Smulja
Miratoi: L. Pula
Q. Abedin



PREFEKTURA SHKODËR



“ILLYRIAN GUARD” SHA

Aneksi nr. 1

1. Tabela e objekteve ku ofrohet shërbimi për Prefekturën Shkodër.
2. Rregullore e Përbashkët e Sigurisë së Objektivit.
3. Mënyra e llogaritjes së tarifës referuar Udhëzimit Nr.407/1 “Për mënyrën e përlllogaritjes së tarifave të shërbimeve specifike, që u ofrohen subjekteve publike, nga shoqëria “Illyrian Guard” Sh.A”.

1. Tabela nr. 1

Objektet në ruajtje për llogari të Prefekturës Shkodër:

Nr	Institucioni	Vendroje	Sistem Elektronik	Turne	Lloji i shërbimit (koeficienti)	Nr. i rojeve	Vlera mujore pa TVSH	Vlera totale per 5 muaj pa TVSH
1	Prefektura Shkodër	1		1	1.18	1.18	84,066.74 Lekë	420,333.7 Lekë
2	-	-	1	-	24 ore	-	190,206 Lekë	951,030 Lekë
Vlera totale (pa TVSH)						1.18	274,272.74 Lekë	1,371,363.7 Lekë

2. Rregullore e Përbashkët e Sigurisë së Objektivit.
3. Mënyra e llogaritjes së tarifës referuar Udhëzimit Nr.407/1 “Për mënyrën e përlllogaritjes së tarifave të shërbimeve specifike, që u ofrohen subjekteve publike, nga shoqëria “Illyrian Guard” Sh.A”.

Nr.	VR	Turnet	Sistem Elektronik	Koha e ruajtjes	Koef.	Roje/ Sistem	Tarifa mujore pa TVSH 1 roje/ 1 sistem	Vlera totale mujore pa TVSH
1	1	1		8 orë/5 ditë	1.18	1.18	71.243,00 Lekë	84,066.74 Lekë
2	0	0	1	24 orë/7 ditë		1	190,206.00 Lekë	190,206.00 Lekë
Totali						1.18 roje/ 1 sistem		274,272.74 Lekë



Handwritten signatures and initials.



PREFEKTURA SHKODËR

Nr. 432/5 Prot.
Shkodër më 20.7.2023



"ILLYRIAN GUARD" SH.A

Nr. 1166 Prot.
Tiranë më 19.07.2023

AMENDIM I KONTRATËS

**me nr. 432/1 prot., datë 29.06.2023 (Prot. i Prefekturës Shkodër)
dhe nr. 1166 prot., datë 29.06.2023 (Prot. i "Illyrian Guard" Sh.A)**

E lidhur sot më datë 20.7.2023 midis palëve:

Prefektura Shkodër, me adresë Rruga "28 Nëntori", Shkodër, me NIPT **K56705030C**, përfaqësuar nga **Znj. Majlinda ANGONI** në cilësinë e Prefekti Qarku Shkodër, tani e tutje të referuar si **"Përfitues i Shërbimit"**

Dhe

Shoqëria "Illyrian Guard" SH.A., me adresë: Rruga "Ibrahim Rugova", Ish Garda e Republikës, Tiranë, me NIPT L91619024U, e përfaqësuar nga Administratori **Z. Robert LILI**, në cilësinë e **"Ofruesit të Shërbimit"**

Baza Ligjore: Ligji Nr. 7850, datë 29.7.1994, "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligj Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", Ligji nr. 75/2014, datë 14.07.2014 "Për Shërbimin Privat të Rujajtjes dhe të Sigurisë Fizike", i ndryshuar, Ligji Nr.10 296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", VKM nr. 177, datë 04.04.2019 "Për krijimin e shoqërisë "Illyrian Guard" Sh.A." dhe për përcaktimin e autoritetit publik, që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të kësaj shoqërie", VKM nr. 113, datë 01.03.2023 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi"; Udhëzimi i Përbashkët i Ministrisë të Brendshme dhe Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr. 90, datë 27.06.2023 "Për miratimin e tarifave të reja të shërbimeve që u ofrohet subjekteve publike, nga Shoqëria "Illyrian Guard" ShA", Kontrata e shërbimit me nr. 432/1 prot., datë 29.06.2023 (Prot. i Prefekturës Shkodër) dhe nr. 1166 prot., datë 29.06.2023 (Prot. i "Illyrian Guard" Sh.A).



Palët bien dakord që në kontratën e shërbimit me nr. 432/1 prot., datë 29.06.2023 (Prot. i Prefekturës Shkodër) dhe nr. 1166 prot., datë 29.06.2023 (Prot. i “Illyrian Guard” Sh.A) të kryhet amendimi si më poshtë:

Neni 1 Objekti i amendimit të kontratës

1.1 Objekt i këtij amendimi është ndryshimi i nenit 3 “Çmimi dhe Vlera e Kontratës” dhe Aneksit Nr. 1 si më poshtë:

Ishte:

Nr	Institucioni	Vendroje	Sistem Elektronik	Turne	Lloji i shërbimit (koeficienti)	Nr. i rojeve	Vlera mujore pa TVSH
1	Prefektura Shkodër	1		1	1.18	1.18	84,066.74 Lekë
2	-	-	1	-	24 ore	-	190,206 Lekë
Vlera totale (pa TVSH)						1.18	274,272.74 Lekë

Behet:

Prefektura Shkoder										
Nr.	Vendroje	Turnet	Koha e ruajtjes	Orari	Koef.	Nr i rojeve/sistemit	Tarifa pa TVSH Mujore 1 roje/ sistem	Vlera Totale Mujore pa TVSH	Vlera Totale 4-mujore pa TVSH	Vlera Totale 4-mujore me TVSH
1	1	Turni I pare	8 ore/ 5 dite	08:00-16:00	1.18	1.18	76,014.00 Lekë	89,696.52 Lekë	358,786.08 Lekë	430,543.30 Lekë
1	Shërbim Sigurie me NVR 8-16 kanale dhe Alarm					1	148,400.00 Lekë	148,400.00 Lekë	593,600.00 Lekë	712,320.00 Lekë
Totali për Prefekturën Shkoder								238,096.52 Lekë	952,386.08 Lekë	1,142,863.30 Lekë

Neni 2

Hyrja në fuqi e amendimit të kontratës

2.1 Amendimi i kontratës hyn në fuqi në datën 01.08.2023 dhe është i vlefshëm deri në datën 30.11.2023.

Neni 3

Dispozita të fundit

3.1 Amendimi i kontratës firmoset në 3 (tre) kopje origjinale dhe bëhet pjesë integrale e kontratës së shërbimit nr. 432/1 prot., datë 29.06.2023 (Prot. i Prefekturës Shkodër) dhe nr. 1166 prot., datë 29.06.2023 (Prot. i “Illyrian Guard” Sh.A).



3.2 Çdo ndryshim në kontratën e shërbimit dhe/ose në këtë amendim do të pasqyrohet nëpërmjet amendimit dhe do të nënshkruhen nga të dy palët.

3.3 Çdo dispozitë e kontratës përveç sa më sipër nenit nr. 3 “Çmimi dhe Vlera e Katërtës” dhe nenit 6 “Kohëzgjatja dhe përfundimi i kontratës” mbetet e pandryshuar dhe detyruese për secilën palë të kësaj kontrate.

3.4 Palët, pasi e lexuan dhe e gjetën atë konform ligjit dhe interesave të tyre, e nënshkruajnë atë me vullnetin e tyre të plotë.

PALËT

PREFEKTURA SHKODËR

PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Majlinda ANGONI



“ILLYRIAN GUARD” SH.A

Administratori

Robert LILI

